Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Genc Zogaj	**05.04.2024**	**16.04.2024**	**2024/0269**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.03.2024, OE “" ECO - FRIENDLY " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0269, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me mbajtese(kapese)per kravata(Tie pin)per PK-ne” me nr. të prokurimit: "214-24-1472-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 21,000.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0269 i dt:27.03.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së

Neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Me dt. 26.02.2024 është publikuar tenderi me titull **"Furnizim me mbajtëse(kapëse)për kravata (Tie pin) për PK-në".**

Ne me dt.07.03.2024 kemi dërguar tek autoriteti kontraktues kërkesë për sqarime në lidhje me logon e cila duhet të gravohet dhe vendoset tek mbajtësi i kravatës. Njëkohësisht e kemi theksuar si në vijim *"Në lidhje me mbajtësin e kravatës ku është cekur që duhet të jetë i punuar nga zinku, ne përmes kësaj kërkesë për sqarim kërkojmë që të lejohet prezantimi i mbajtësit të kravatës edhe nga bronzi jo vetëm nga zinku për faktin se bronzi është shumë më praktik për përdorim afatgjatë si dhe njëkohësisht është material jo i rrëshqitshëm*".

Me dt.11.03.2024 neve na është kthyer përgjigjja nga ana e AK-së, ku na janë prezantuar edhe disa foto tjera ilustruese, mirëpo në lidhje me kërkesën tonë që të lejohet të bëhet prezantimi i mbajtësit të kravatës edhe nga bronzi, AK-ja e ka cekur referojuni specifikimeve teknike.

Pasi që me kërkesë për sqarime nuk është lejuar të prezantohet mbajtësi i kravatës edhe nga bronzi dhe jo vetëm nga zinku, atëherë ne përmes kësaj ankese kërkojmë edhe një herë nga

3/6

OSHP që të detyrojë autoritetin kontraktues që të na lejoj të prezantojmë mbajtësin e kravatës edhe nga bronzi, pasi që një gjë e tillë nuk ndikon negativisht në këtë aktivitet të prokurimit.

Për më tepër materiali bronz është shumë më praktik për përdorim afatgjatë dhe është material i cili nuk rrëshqet, pra nga ky fakt kuptohet qartë se është shumë material më i mirë bronzi se sa zinku.

Ne kemi kërkuar që pasi të sqarohen kërkesat tona nga ana e autoritetit kontraktues kërkojmë që të lejojë një afat të konsiderueshëm për të ofertuar, pasi që siç e din edhe autoriteti kontraktues prodhimi mostrave kërkon një kohë prej minimum 20 ditë, duke mos e përfshirë edhe kohën e transportit të mostrave.

Andaj përmes kësaj ankese kërkojmë nga ana e OSHP-së që të detyroj autoritetin kontraktues pasi që të vërtetohen pretendimet tona ankimore të zgjatet afati për dorëzimin e ofertave edhe për minimum 20 ditë nga data e hapjes së ofertave.

Ne me dt.18.03.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk na janë dhënë arsye konkrete për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj vetëm i ka përsëritur nenet të cilat ne kemi pretenduar se janë shkelur dhe është arsyetuar se kinse të njëjtat janë respektuar. Sa i përket pretendimit tonë ankimor, autoriteti kontraktues e ka cekur se specifikat teknike janë hartuar në harmoni të plotë me LLP dhe Rregulloren Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik.
Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm për faktin se ne e kemi sqaruar qartë se nëse lejohet të përdoret edhe materiali bronz, atëherë jo vetëm që do të hapej konkurrenca mirëpo në këtë rast do të përfitonte edhe autoriteti kontraktues, pasi që materiali bronz është material që nuk rrëshqet dhe njëkohësisht është material më i qëndrueshëm dhe më praktik se sa zinku.

Këtë arsyetim tonin autoriteti kontraktues nuk e ka marr parasysh fare, andaj ne kërkojmë nga ana e OSHP-së që ti analizoj pretendimet tona ankimore dhe të detyroj autoritetin kontraktues që përveç zinkut të i lejoj OE e interesuar për ofertim të prezantojnë produktet edhe nga bronzi.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*".
Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit dhe nuk mund të ketë konkurrencë të hapur.
Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë;* ***(i)*** *pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit".*

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është pas parasysh as nenin 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku

shkruan qartë që *"Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".*

Duke u bazuar në të gjitha këto kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se *"Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike".*

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"ECO – FRIENDLY" SH.P.K. NDRYSHOHEN** kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Nr	EMËRTIMI I ARTIKULLIT	NJËSIA MATSE	SASIA
Mbajtesi i kravatës duhet të ketë diemnsione të përgjithshme 55mm X 7mm. Të ketë stemën e Policisë së Kosovës te inkorporuar në anën e djathtë me dimensione 15 mm X 16 mm. Mbajtësi i kravatës duhet të jetë i punuar nga zinku dhe i ngjyrosur apo i larë me ngjyrë argjend ose ari, varesisht nga gradat e policisë , mbrapa duhet të ketë poashtu kapësen për mbajtje (fotot per ilustrim).			
	Mbajtësi i kravatës (kapëse) për zyrtarët policor dhe rreshter (TIE PIN)- ngjyrë argjendi		

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Eksperti me kete rast ka kerkuar informacione shtese nepermjet email-it lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues i cili po pretendon qe produkti i kerkuar mund te ofrohet edhe ne materialin e bronzit. Eksperti gjithashtu ka dale ne terren dhe ka konsultuar disa prej zejtarëve lokal te cilet punojne pune te ngjashme me materiale te tilla dhe si perfundim te gjithe dhane informaten e njejte se keto produkte ne tregun tone ne shumicen e rasteve punohen nga materiali i zinkut dhe se shumice prej tyre nuk kishin njohuri nese ndonjehere eshte punuar apo mund te behet dicka e tille prej materialit bronz.

Nr	EMËRTIMI I ARTIKULLIT	NJËSIA MATSE	SASIA
Mbajtesi i kravatës duhet të ketë diemnsione të përgjithshme 55mm X 7mm. Të ketë stemën e Policisë së Kosovës te inkorporuar në anën e djathtë me dimensione 15 mm X 16 mm. Mbajtësi i kravatës duhet të jetë i punuar nga zinku dhe i ngjyrosur apo i larë me ngjyrë argjend ose ari, varesisht nga gradat e policisë , mbrapa duhet të ketë poashtu kapësen për mbajtje (fotot per ilustrim).			
	Mbajtësi i kravatës (kapëse) për zyrtarët policor dhe rreshter (TIE PIN)- ngjyrë argjendi		

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" ECO - FRIENDLY " SH.P.K.**

PERGJIGJE NE PRETENDIMIN ANKIMOR:

Nr	EMËRTIMI I ARTIKULLIT	NJËSIA MATSE	SASIA
Mbajtesi i kravatës duhet të ketë diemnsione të përgjithshme 55mm X 7mm. Të ketë stemën e Policisë së Kosovës te inkorporuar në anën e djathtë me dimensione 15 mm X 16 mm. Mbajtësi i kravatës duhet të jetë i punuar nga zinku dhe i ngjyrosur apo i larë me ngjyrë argjend ose ari, varesisht nga gradat e policisë , mbrapa duhet të ketë poashtu kapësen për mbajtje (fotot per ilustrim).			
	Mbajtësi i kravatës (kapëse) për zyrtarët policor dhe rreshter (TIE PIN)- ngjyrë argjendi		

Eksperti ka marre pergjigje me shkrim nga AK perkatesisht nga njesia kerkuese ku gjejme pergjigjen si me poshte:

PËRGJIGJEJE.

Të nderuar/a, Sipas konsultimeve me anëtaret e komisionit, ne si komision i hartimit te specifikave teknike kemi berë hulumtimin e tregut dhe paraprakisht jemi bazuar ne kontratat paraprake, se Mbajtëset e kravatës (kapëse) për zyrtarët policor (TIE PIN). Kane qen te punuara nga materiali zinkut dhe mbajtëse te kravatave te tilla ne treg me tjetër material nuk ka pasur.

Dhe përgjigjeja jonë është që...

Mbajtësi i kravatës (kapëse) për zyrtarët policor (TIE PIN) te jenë te punuara nga materiali i zinkut dhe konform dimensioneve dhe dizajnëve që ne i kemi kërkuar.

Ne si komisionin i hartimit te specifikave teknike, qëndrojmë mbrapa kërkesave tona dhe specifikave teknike te cilat i kemi hartuar.

Andaj duke marre per baze hulumtimet e lartecekura dhe sqarimet e marra ne tregun tone si dhe pervojat e kaluara del te jete qe ky material te jete i perdorur gjere dhe me se shumti ne treg lidhur me produkte te tilla dhe te ngjashme, eksperti thekson qe ky pretendim i OE ankues eshte i pabazuar dhe se nuk ka ofruar mjaftueshem fakte lidhur me kundershtimet e tyre lidhur me materialin e kerkuar ne dosje te tenderit dhe se sipas sqarimeve te bera nga njesia kerkuese eshte me se e arsyeshme qe nuk guxojne te kerkojne produkte ekuivalente ngase atehere do te mundesohej qe te ofertohet edhe me materiale plastike apo te ngjashme te cilat nuk do te ishin te pershtatshme duke marre per baze rendesine e institucionin ne kete rast Policise se Kosoves.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" ECO - FRIENDLY " SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Genc Zogaj